(c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

(d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Vlerësimit;
4. Kriteret e Përzgjedhjes;
5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
6. Preventivin e çmimeve
7. Termat e referencës (nëse është rasti)
8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
---	--

<sup>4</sup> Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b>	

**Shtojca 2.**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa vlerë do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

**Oferta ekonomike e detajuar**

<b>Nr</b>	<b>Nr. Analizë</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>	<b>Njësi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi/Njësi</b>	<b>Cmimi total</b>
1.						
2.						
3.						
<b>Shuma</b>						
<b>Fondi Rezervë</b>						
<b>Shuma</b>						
<b>TVSH</b>						
<b>SHUMA TOTAL</b>						

**Nënshkrimi i ofertuesit** \_\_\_\_\_

**Vula**

**Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )

### Shtojca 3.

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]*

#### **FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS**

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*  
Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

\* \* \*

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*  
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*  
Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,  
*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.*

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit /entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

**Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet** të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

**SHËNIM:** Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

#### 1. Boje bikomponente sprajt e bardhe.

##### 1.1 Boja

Produkti që do të ofrohet duhet të jetë material shenjëzimi rrugor me bazë plastikë të ftohtë (cold plastic), dy-komponentësh, pa tretës (solvent-free), për aplikim me spërkatje mekanike, i projektuar për qëndrueshmëri të lartë në kushte trafiku intensiv dhe përdorim afatgjatë.

Sistemi I aplikimit për bojën bikomponente sprajt duhet të jetë 98:2

Produkti duhet të jetë i destinuar për përdorim me ruaza qelqi reaktive të veshura me katalizator.

##### 1.2. Specifikime për përbërjen dhe vetitë fiziko-kimike të materialit

Produkti duhet të plotësojë minimalisht karakteristikat e mëposhtme:

- Lloji i materialit: plastikë e ftohtë reaktive, dy-komponentëshe
- Ngjyra: e bardhë
- Pigment: dioksid titani (TiO<sub>2</sub>) ose ekuivalent teknik
- Lidhësi (binder): rrëshirë metakrilike ose ekuivalente
- Dendësia në 20°C: 1.6 – 1.8 kg/l
- Viskoziteti në 25°C: rreth 80 KU ±5
- Përmbajtja e substancës solide: ≥ 98%
- Konsumi teorik i materialit: 0.6 – 0.8 kg/m<sup>2</sup>

- Koha e punueshmërisë (pot life) në 25°C: minimum 10 minuta maksimum 25 minuta
- Hollimi: nuk lejohet hollimi me tretës
- Trashësia tipike e shtresës së aplikuar: rreth 1.2 – 1.6 mm

Materiali duhet të garantojë rezistencë të lartë ndaj konsumit mekanik, ngarkesave të trafikut dhe kushteve atmosferike.

### 1.3. Metoda e aplikimit dhe kushtet e punës

Aplikimi i materialit duhet të realizohet vetëm me makineri profesionale shenjzimi rrugor me spërkatje, të pajisura me sistem shpërndarjeje të ruazave qelqi.

- Aplikimi duhet të shoqërohet me shpërndarje të vazhdueshme të ruazave qelqi reaktive mbi filmin e freskët të materialit.
- Ruazat duhet të depërtojnë në trashësinë e filmit për të garantuar ngurtësimin (polimerizimin) dhe reflektimin.
- Aplikimi i materialit pa ruaza reaktive ose me mbulim jo të plotë konsiderohet teknikisht i papranueshëm.
- Shenjzimi i aplikuar duhet të mbrohet nga trafiku deri në katalizimin e plotë të materialit.

Kushtet minimale klimatike të aplikimit:

- Temperatura e sipërfaqes:  $\geq +12^{\circ}\text{C}$
- Temperatura ambientale: minimum  $5^{\circ}\text{C}$  mbi pikën e vesës
- Sipërfaqja duhet të jetë e thatë, e pastër dhe pa ndotje (vajra, pluhur, karburante, kripëra, etj.).

### 1.4. Kërkesa për ruazat qelqi reaktive (drop-on beads)

Ruazat qelqi që do të përdoren për shenjzim duhet të përmbushin minimalisht kërkesat e mëposhtme:

- Standardi: SSH EN 1423
- Fraksioni granulometrik: 300 – 850  $\mu\text{m}$
- Indeksi i thyerjes:  $\geq 1.5$  (Klasa A)
- Rrumbullakësia (roundness):  $\geq 80\%$
- Veshje reaktive (coating): e detyrueshme për aktivizimin e ngurtësimit të materialit
- Përmbajtja e substancave të rrezikshme (As, Pb, Sb): Klasa 1 sipas SSH EN 1423 ( $< 200$  ppm)
- Ambalazhimi: thasë 25 kg neto
- Afati minimal i ruajtjes:  $\geq 6$  muaj në kushte të thata dhe të mbrojtura

### 1.5. Kërkesa për certifikim dhe performancë

Boja bikomponente spray duhet të jetë e certifikuar nga një institucion i pavarur dhe i akredituar european për sisteme shenjzimi rrugor me plastikë të ftohtë dhe ruaza qelqi, në përputhje me standardet SSH EN 13197 dhe SSH EN 1436, duke përmbushur minimalisht klasat e mëposhtme:

Lloji i materialit: Substance reaktive me ngurtësim në të

ftohtë (plastike me spërkatje të ftohte)

Forcuesi: 1/1 (1% forcues pluhuri)

Trashësia e shtresës ( $\mu\text{m}$ ): 600

Procedura e aplikimit: Teknike me spërkatje

Sasia e trupave reflective: 300  $\text{g}/\text{m}^2$

Të përmbushen kërkesat për klasen e trafikut P7. Për karakteristikat individuale të karakteristikave të trafikut të arrihen klasat si më poshtë:

Kapja  $\geq S 1$

Shikushmeria natën në të thatë: R 4

Shikushmeria natën në lagështirë: RË 3

Shikushmeria ditën: Q 5

Rotullueshmeria: T 2

Të përmbushen kërkesat minimale për rezistencën ndaj konsumit prej 90% të sipërfaqes së mbetur.

Vlerat mesatare të matura të jenë:

Klasa e kërkuar e trafikut: P 7  
 Klasa e aritur e trafikut: P 7  
 Koha e tharjes (min): 9

Karakteristikat Fiziko-Kimike:

		Shuma e rotullimit te gomes								
Karakteristikat		0	0.01	0.1	0.2	0.5	1	2	3	4
Rezistenca ndaj konsumit (%)		100		100	100	100	100	100	100	100
Kapja (Njesi – SRT)		71		54	52	49	48	46	45	43
Shikushmeria naten	E thate	126	215	314	322	373	355	376	393	392
	E Lagësht	67		97	109	82	115	77	98	80
Shikushmeria ditën		260		267	250	255	241	248	253	259
Vlera standarte e ngjyres Kordinatat		X = 0.327				Y = 0.343				

Boja duhet të jetë e ambalazhuar në kova me peshë 25 kg.

Në trupin e kovës duhet të shënohet data e prodhimit dhe/ose skadencës së saj.

**1.6 KATALIZATOR I LËNGSHËM**

Ne dukje I bardhe ose krem, me permbajtje dibenzoyl peroxide dhe 40% plastifikues. Me jetegjatesi minimumi 6 muaj, me ambalazh jo me pak se 15 kg. Perdoret ne sasi nga 1% deri ne 4% ne varesi te temperaturave te ambientit.

**1.7 FOSFORI (Perlina Xhami):**

Janë të disponueshme gama të ndryshme.

Të gjitha ato të respektojnë standardet EN 1423 dhe të kenë certifikimin CE.

125-600	Per te gjitha produktet
125-850	Per te gjitha produktet
125-1180	Per te gjitha produktet

Fosfori duhet te jete i ambalazhuar ne thase me peshe nga 25-30 kg.

**2. TABELAT DUHET TË KENË KËTO SPECIFIKIME TEKNIKE:**

Tabelë alumin, të gjitha shenjat rrugore të jenë me llamarinë aliazhi të aluminit, jo më pak se 2,5 mm sipas kërkesave të projektit. Çdo sinjal duhet te jetë i përforcuar në të gjithë perimetrin e tij me

një bordurë të kthyer. Të gjitha sinjalet në pjesën e pasme duhet të përmbajnë elemente konstruktive, të cilët të bëjnë të mundur mbërthimin e saj në bishtin e tabelës. Shenjat me sipërfaqe më të madhe se 0,8m<sup>2</sup>, disqet dhe tetëkëndeshat me diametër 90cm, shenjat drejtuese etj, duhet të kenë elemente përforcues në pjesën e pasme të tyre për gjithë gjatësinë. Pjesa përforcuese duhet të jetë e përshtatshme për rreshqitje dhe mbërthim në të tërë gjatësinë e stafave montuese në mbajtëse të shenjës. Tabelat të plotësojnë standartet EN 12899-1:2007.

### 2.1 Lidhjet e tabelës me mbajtësen:

Çdo tabelë duhet të lidhet në pjesën e sipërme dhe të poshtme të saj me mbajtësen duke garantuar soliditetin me një numër të mjaftueshëm të bullonave prej çeliku të xinguar në pjesën e pasme të tabelës.

Ndërsa për evitimin e fenomeneve të vandalizmit, bullonat duhet të jenë të tillë që duke parë nga pjesa e pasme e tabelës kokat e tyre të jenë cilindrike me heksagon brenda.

#### KËRKESA TË PËRGJITHSHME TË PËRFORMANCËS

Parametri	Specifikim Minimal
Klasa e reflektimit	RA2 sipas EN 12899-1
Klasa e kromaticitetit / ndriçimit	CR2 sipas EN 12899-1
Teknologjia e reflektimit	Mikro-prizmat e orientuara në formë të mbyllur (sealed microprisms)
Materiali bazë	Film plastik me shumë shtresa (PVC / PMMA) me shtresë mbrojtëse UV
Ngjyrat standarde	E bardhë, e verdhë, e kuqe, blu, jeshile, kafe, portokalli, gri
Koeficienti i reflektimit RA (cd/m <sup>2</sup> /lx)	Sipas klasës RA2 (tabelat referuese më poshtë)
Simetria e reflektimit	≤ 2.5 : 1 sipas EN 12899-1
Rezistenca ndaj ndikimeve mekanike	Pa çarje ose delaminim jashtë rrethit me rreze 6 mm nga pika e goditjes
Rezistenca ndaj motit	Plotëson kërkesat e qëndrueshmërisë 3-vjeçare natyrore dhe artificiale (sipas EN 12899-1)
Koeficienti i ndriçimit pas plakjes	≥ 80% e vlerave fillestare pas ekspozimit natyral ose artificial
Klasa e qëndrueshmërisë ndaj ndikimeve atmosferike	CR1 pas motit artificial/natyror
Jetëgjatësia minimale e deklaruar	≥ 10 vjet në kushte standarde evropiane
Përputhshmëri me ligjet dhe direktivat e BE	Sipas Rregullores (BE) Nr. 305/2011 (Rregullorja e Produkteve të Ndërtimit – CPR) dhe EN 12899-1 për sinjalistikën vertikale

### 2.2 Kompozimi (përbërja e Celuloidit) e faqes së përparme të tabelës, (Adezivi):

Adezivi duhet të jete, class II.

Koeficienti minimal fillestar i retroreflektivitetit e intensitet të lartë Prizmatik, sipas matjeve të CIE 54.2 duke përdorur standartet e iluminimit A, konform tabelës A dhe B.

Tabela 1 – Koeficienti specifik I reflektivitetit (CUAP klas R2, DIN 67520:2013-10 RA2)				
Këndi vëzhgimit	I	0.2°	0.33°	2°

Këndi I hyrjes	5°	30°	40°	5°	30°	40°	5°	30°	40°
E bardhë	250	150	110	180	100	95	5	2,5	
E Verdhë*	170	100	70	122	70	64	3	1,5	
E kuqe	45	25	15	25	14	13	1,0	0,4	
Jeshile	45	25	12	21	12	11	0,5	0,3	
Blu	20	11	8	14	8	7	0,2	#	
Kafe	12	8,5	5	8	5	3	0,2	#	

\*gjithashtu  
për të verdhën  
fluoreshente

Tabela 2 – Koeficienti specifik I reflektivitetit (ASTM D4956-17 Tipi IV I adezivit)

Këndi I vëzhgimit	0.1°		0.2°		0.5°	
	-4°	30°	-4°	30°	-4°	30°
E bardhë	500	240	360	170	150	72
E Verdhë	380	175	270	135	110	54
Portokalli	200	94	145	68	60	28
E Kuqe	90	42	65	30	27	13
Jeshile	70	32	50	25	21	10
Blu	42	20	30	14	13	6
Kafe	25	12	18	8,5	7,5	3,5
Fluoreshente e verdhë- jeshile	400	185	290	135	120	55
Fluoreshente e verdhë	300	140	220	100	90	40

Koordinatat kromatike të ngjyrave sipas tabelave më poshtë gjatë ditës:

Tabela 3 – Koordinatat kromatike (DIN 6171-2003-08)									
Ngjyrat	1		2		3		4		Faktori I luminancë s β
	x	y	x	y	x	y	x	y	
E Bardhë	0,305	0,315	0,335	0,345	0,325	0,355	0,295	0,325	> 0.27
E Verdhë	0,494	0,506	0,470	0,480	0,513	0,437	0,545	0,455	> 0.16
E Kuqe	0,735	0,265	0,700	0,250	0,607	0,343	0,655	0,345	≥ 0.03
Jeshile	0,007	0,703	0,216	0,448	0,147	0,400	0,018	0,454	≥ 0.03

Blu	0,100	0,109	0,146	0,156	0,183	0,115	0,137	0,038	$\geq 0.01$
Kafe	0,455	0,397	0,523	0,429	0,479	0,373	0,558	0,394	0.03 – 0.09
Table 4 – Koordinatat kromatike (ASTM D495-17)									
Ngjyrat	1		2		3		4		Faktori I luminancës (Y %)
	x	y	x	y	x	y	x	y	
E Bardhë	0,303	0,300	0,368	0,366	0,340	0,393	0,274	0,329	$> 27$
E Verdhë	0,498	0,412	0,557	0,442	0,479	0,520	0,438	0,472	$15 \leq Y \leq 45$
Portokalli	0,558	0,352	0,636	0,364	0,570	0,429	0,506	0,404	$10 \leq Y \leq 30$
E kuqe	0,648	0,351	0,735	0,265	0,629	0,281	0,565	0,346	$2.5 \leq Y \leq 15$
Jeshile	0,026	0,399	0,166	0,364	0,286	0,446	0,207	0,771	$3 \leq Y \leq 12$
Blu	0,140	0,035	0,244	0,210	0,190	0,255	0,065	0,216	$1 \leq Y \leq 10$
Kafe	0,430	0,340	0,610	0,390	0,550	0,450	0,430	0,390	$1 \leq Y \leq 9$
Fluoreshen te verdhe- jeshile	0,387	0,610	0,369	0,546	0,428	0,496	0,460	0,540	$\geq 60$
Fluoreshen te e verdhe	0,479	0,520	0,446	0,483	0,512	0,421	0,557	0,442	$\geq 40$

### 3. PËRVIJUES:

#### 3.1 F.V. Përvijues modularë të kthesave (çiftë)

*Ky zë përdoret për sinjalizimin e kthesave të forta dhe të rrezikshme (shigjetat që tregojnë drejtimin e kthesës).*

- Përshkrim i Përvijues modularë për kthesa të rrezikshme (panore me shigjeta), të përbërë nga elemente çift (majtas/djathtas ose sipas sensit të lëvizjes), të montuar mbi barrierën metalike (guardrail).
- Materiali i pllakës: Pllakë alumini me trashësi minimale 2.0 mm ose çelik i galvanizuar nxehtë (sipas EN ISO 1461) me trashësi minimale 1.5 mm. Tehet duhet të jenë të palosura (represuara) për siguri konstruktive.
- Klasa e Reflektimit: Film retroreflektues i Klasit 2 (High Intensity Prismatic - HIP) ose Klasit 3. Për rrugët rurale, Klasi 2 është minimumi i kërkuar për dukshmëri të lartë gjatë natës.
- Kodi i Ngjyrave: Shigjeta në ngjyrë të zezë mbi sfond të bardhë (ose shigjetë e bardhë mbi sfond blu, në varësi të projektit specifik të miratuar nga ARRSH).
- Sistemi i Montimit: Konstruksion metaliko-mekanik (suport/klapë) i tjetërsueshëm që fiksohet direkt në postet (shtyllat vertikale) ose trarin e guardrailit pa bërë shpime të reja. Të gjitha vidat, dadot dhe rondelat duhet të jenë Inox (A2 ose A4).
- Matja e punës: Paguhet për çift (ose për copë paneli modular të kompletuar) të furnizuar dhe vendosur në vend.

#### 3.2 F.V. Përvijues (delineatorë) normalë anësorë

*Ky zë përdoret për të treguar vijën anësore të rrugës në pjesët e drejta ose me kthesa të buta.*

- Përshkrim i Përvijues normalë anësorë (delineatorë) për rrugë të drejta, të montuar mbi trarin e barrierës mbrojtëse metalike (guardrail).

---

- Materiali: Trup plastik elastik i dëndur (HDPE/PVC me rezistencë ndaj goditjeve) ose pllakë metalike e zinguar/alumini (në formë "L" ose trapezoidale). Trupi duhet të ketë fleksibilitet për t'u kthyer në pozicionin fillestar në rast goditjeje të lehtë.

- Elementet Reflektuese (Sipas EN 12899-3):

Në krahun e djathtë: Element reflektues drejtkëndor ose rrethor në ngjyrë të kuqe (ose portokalli).

Në krahun e majtë: Element reflektues në ngjyrë të bardhë (ose dy pika të bardha vertikale).

Cilësia e filmit: Film retroreflektues mikroprizmatik i Klasit 2.

- Montimi: Fiksim i plotë mbi trarin e guardrailit duke përdorur bulonën ekzistuese të lidhjes së barrierës. Përdorimi i dadove antishkatërrim (anti-vandalizëm) është i detyrueshëm për të parandaluar vjedhjet.

- Matja e punës: Paguhet për copë të furnizuar dhe vendosur plotësisht në objekt.

3.3 Specifikime të Përbashkëta për përvijues:

Rezistenca Atmosferike: Çertifikim për rezistencë të lartë ndaj rrezeve UV (garanci kundër zbehjes së ngjyrave për minimumi 5 vjet) dhe ndaj temperaturave  $\{(-20^{\circ}\text{C})\text{ deri në } +60^{\circ}\text{C}\}$ .

#### 4. PLLAKA FOSFORISHENTE METALIKE:

##### 4.1 Karakteristikat e Materialit Bazë (Pllakës)

- Materiali struktural: Alumini i eloksatizuar (trashësi minimale 2.0 mm) ose Çelik i galvanizuar nxehtë (trashësi minimale 1.5 mm) sipas standardit EN ISO 1461.

- Forma: Trapezoidale ose kënddrejtë në formë "L" apo "U", e projektuar për t'u përshtatur saktësisht me profilin e valëzuar të guardrailit ekzistues (Profil A ose B).

- Përpunimi: Këndet duhet të jenë të rrumbullakosura për të parandaluar rreziqet e prerjes gjatë montimit apo aksidenteve.

##### 4.2 Specifikimet e Filmit Reflektues dhe Fosforishent (Fotolumineshent)

- Kombinimi i Teknologjisë: Pllaka duhet të ketë veprim të dyfishtë sigurie:

1. Shtresë Fotolumineshente (Fosforishente): Cilësi e lartë, që përthith dritën natyrale dhe siguron shkëlqim të vazhdueshëm në errësirë të plotë pa ndriçim aktiv për një kohëzgjatje prej 8-12 orësh.

2. Film Retroreflektues: Klasifikimi sipas standardit EN 12899-1. Për rrugët lokale midis fshatrave kërkohet minimalisht Klasi 2 (High Intensity Prismatic - HIP).

- Kodi i Ngjyrave (Sipas sensit të lëvizjes):

1. Ngjyrë e Kuqe / Portokalli: Për delineatorët që vendosen në krahun e djathtë të lëvizjes.

2. Ngjyrë e Bardhë / e Verdhë: Për delineatorët që vendosen në krahun e majtë të lëvizjes (në rastet e rrugëve me dy drejtime pa trafikndarës).

##### 4.3 Sistemi i Fiksimit dhe Aksesorët (Mbi Guardrail)

- Mënyra e montimit: Montimi do të bëhet pa shpime të reja në trarin e barrierës metalike, për të mos dëmtuar zinkimin e saj. Pllaka duhet të fiksohet direkt në bulonat lidhës ekzistues të elementëve të guardrailit.

- Elementët e fiksimit: Bulona, rondela dhe dado antishkatërrim (anti-vandalizëm) prej çeliku Inox (A2 ose A4) për të garantuar qëndrueshmëri ndaj korrozionit dhe dridhjeve të vazhdueshme të shkaktuara nga mjetet.

##### 4.4 Rezistenca dhe Jetëgjatësia

- Rezistenca ndaj agjentëve atmosferikë: Rezistencë maksimale ndaj rrezeve UV (për të

parandaluar zbehjen e ngjyrës), temperaturave ekstreme (-20°C deri në 60°C) dhe kripërave që përdoren për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve.

- Jetëgjatësia e filmit: Garanci teknike e prodhuesit për performancën fotolumineshente dhe reflektuese për një periudhë minimale prej 5 vitesh.

## 5 NDRIÇIMI

Tipi ndriçuesit që do të përdoret duhet të jetë i pavarur nga sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike, pra duhet të furnizohet nëpërmjet paneleve fotovoltaikë.

Për të minimizuar konsumin e energjisë, ndriçimi duhet të jetë i tipit LED si dhe të jetë pozicionuar në distancën deri në 9 m nga sipërfaqja e asfaltit në mënyrë që të ofroj ndriçimin e nevojshëm për sipërfaqen e parashikuar të mbulimit.


Karakteristika e tij duhet të jenë në përputhje të standartit evropian *EN 13201-2:2015 "Ndriçimi rrugor*. për të garantuar cilësinë e produktit. Duke qenë një element komplet autonom, si dhe duke pasur parasysh që mirëmbajtjet do të jenë të niveleve të ulëta, atëhere është e nevojshme që produkti të jetë i një cilësie maksimale.

Ndriçuesi duhet të ketë të inkorporuar përveç llampës LED edhe baterinë me panelin fotovoltaik, të gjitha këto si një trup i vetëm të montuara në nivelin e ndriçuesit (deri 9 m mbi asfalt) në mënyrë që të shmangen dëmtime ose vjedhje të elementeve të pavarur të ndriçuesit.

Për më tepër, specifikimet teknike që duhet të plotësoj ndriçuesi të jenë si më poshtë:

- |  |   |
|--|---|
| • Mbulesa optike/model lente                       | Polikarbonat e stabilizuar e tipi UV                              |
| • Marka CE   | Në përputhje me EN 13201-2:2015                                   |
| • Materiali  | Alumin i derdhur nën presion                                      |
| • Periudha e Garancise                             | Minimale për 5 vjet   |
| • Gjatësia e përgjithshme                          | 1080 mm   |
| • Gjerësia e përgjithshme                          | 345 mm  |
| • Lartësia e përgjithshme                          | 50 mm   |
| • Ngjyra   | RAL 7035  |
| • Lloji i baterisë                                 | Litium ferrofosfat  |
| • Amper-orë e baterisë                             | 60Ah  |
| • Tensioni i baterisë                              | 12.8 V  |
| • Ciklet e karikimit dhe shkarkimit të baterisë    | 2000  |
| • Tipi i panelit                                   | Polikristalin   |
| • Tensioni i panelit                               | 30 V  |
| • Fuqia maksimale e panelit                        | 70W   |
| • Kodi i mbrojtjes nga depërtimi                   | IP65[I mbrojtur nga depërtimi pluhurit, i papërshkueshëm nga uji] |
| • Kodi i mbrojtjes nga ndikimi mekanik             | IK08 [ 5 J i mbrojtur nga vandalët]                               |
| • Fluksi fillestar i ndriçimit (fluksi i sistemit) | 200-9000 lm   |
| • Efikasiteti fillestar i ndriçuesit LED           | 175 lm/W  |
| • Temperatura e ngjyrave korr. fillestare          | 2700-6500 K   |
| • Indeksi i interpretimit të ngjyrave fillestare   | >70   |
| • Performanca e LED-it                             | 90W   |
| • Jetëgjatësia mesatare                            | 50000 h   |
| • Gama e temperaturës së ambientit                 | 0 °C deri +35 °C  |
| • Gama e temperaturës së ambientit për karikim     | °C deri +45 °C  |
| • Gama e temperaturës së ambientit për shkarkim    | -20 °C deri +65 °C  |

- (kur drita është e ndezur)
- Profili i errësimit diellor 30% muzgu deri në agim, 100% në lëvizje (Sensori çaktivizohet për 5 orë, pas 5 orë)



## 6 BARRIERAT MBROJTËSE

### 3.1 Vlerësimi i performancës dhe klasifikimi i sistemeve mbrojtjes së automjeteve (VRS)

Nga 1 janari 2011 është e detyrueshme që të gjitha sistemet e mbrojtjes së automjeteve të instaluar në mënyrë të përhershme në rrugët e Komunitetit Evropian të kenë Çertifikim. Për të marrë një Çertifikim të tillë, është e nevojshme të vazhdohet në përputhje me specifikimet e standardit të harmonizuar të UNE EN-1317. Ky standard klasifikon dhe vlerëson performancën e sistemeve të mbrojtjes të automjeteve me anë të testeve të përplasjes në shkallë të plotë.

VRS duhet të instalohen në kushte të ngjashme me ato të aplikuara në provë dhe në përputhje me specifikimet në Manualin e Instalimit të Prodhuarit.

Parametrat që përcaktojnë cilësitë e një sistemi të kontrollit të automjeteve dhe e klasifikojnë atë brenda standardit EN 1317 janë: *niveli i kontrollit, gjerësia e punës, devijimi dinamik dhe ashpërsia e ndikimit.*

- Niveli i kontrollit: Ai tregon aftësinë e një sistemi të kontrollit për t'i bërë ballë ndikimit të ngarkesës së një automjeti.

---

- Gjerësia e punës: është distanca midis faqjes nga ana e trafikut të sistemit të bllokimit përpara ndikimit, dhe pozicionit më të largët anësor të arritur nga çdo pjesë thelbësore e sistemit të mbajtjes dhe automjetit.

- Devijimi Dinamik: Ky është zhvendosja anësore maksimale e fytyrës së trafikut të sistemit të bllokimit gjatë ndikimit.

- Ashpërsia e ndikimit: është një indeks që vlerëson dëmin e pësuar brenda automjetit në një ndikim kundër një sistemi frenimi.

- Ridrejtimi: Kjo është aftësia e një sistemi ndalimi për të kthyer një automjet në rrugë në mënyrë të kontrolluar pas përplasjes me këtë sistem ndalimi.

Barrierat mbrojtëse janë element prej çeliku të zinkuar të cilët shërbejnë për të shmangur daljen e mjetit nga rruga në rastet kur drejtuesi humbet kontrollin. Pjesët përbërëse të barrierave mbrojtëse janë:

- Elementi horizontal (binarët)

- Elementet vertikale (shtylla mbajtëse), të cilët ngulen në tokë dhe shërbejnë për lidhjen e elementeve horizontale.

- Elementet fundor për fillimin/mbylljen e segmenteve të barrierave.

- Aksesoret për montim (dado, bullona, rondela dhe pllakeza lidhese)

Në varësi të rethanave, barrierat mbrojtëse mund të jenë:

- Barriera të njëanshme (të montuara në njërin anë të shtyllës mbajtëse)

- Barriera të dyanshme (të montuara në të dy anët e shtyllës mbajtëse)

Barrierat mund të montohen:

- Direkt në shtyllën mbajtëse

- Indirekt nëpërmjet distancatorëve

Në varësi të tipit të guardrail, binarët mund të jenë të valëzuar me dy valë ose me tre valë, ndërsa shtyllat janë elementë të profilizuar me seksion U, C ose dopio T. Materiali i përdorur për barrierat mbrojtëse është çeliku i zinkuar në të nxehtë në mënyrë që të shmangët ndryshkja e elementëve.

Aksesorët për montim duhet të realizohen nga materiale të cilat janë në pajtueshmëri me materialin e binarëve dhe shtyllave.

Klasat e çelikut të përdorur janë si më poshtë:

- Binarët klsasa e çeliku S 275 JR

- Shtyllat klsasa e çeliku S 275 JR

- Dado, bulona klsasa e çeliku 8.8

### 3.2 Tipet

Tipi i barrierave mbrojtëse përcaktohet në varësi të kategorisë së rrugës nivelit të rrezikut si dhe të parametrave të përmëndur më sipër. Në bazë të këtyre dy kritereve përcaktohet tipi i binarëve (me dy ose tre valëzime) si dhe distanca mes shtyllave (këmbëve) mbajtëse.

Tipi i guardrail për nivel mbrojtje H1 -Ë3 është i paraqitur skematikisht si më poshtë:



---

*SSH/UNI/DIN/EN/ISO, të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit.”*

## Shtojca 6.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

#### Afatet e realizimit të punimeve:

Afatit: 3 Javë Kalendarike				
Nr	Përshkrimi i Punimit	Java 1	Java 2	Java 3
1	Vijëzim shirita gjatësor dhe anësor	■	■	■
2	Tabela "Ndalim" D=60	■	■	
3	Tabela trekëndore A=90	■	■	
4	Përvijues modularë kthesash		■	■
5	Sinjale drejtimi interurban		■	■
6	Përvijues anësor	■	■	■
7	Ndriçim LED me panel diellor		■	■
8	Guardrail H1 anësore	■	■	■
9	Pllakë fosforishente metalike		■	■

#### Legjenda

- ■ = Intensitet më i lartë pune
- ■ = Punime normale
- ■ = Përfundime/detaje finale

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

## Shtojca 7.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 8.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

---

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

*2.1.1 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale të vlefshme për realizimin e objektit të kontratës, e lëshuar nga organi kompetent përkatës për kategorinë: N.S – 6/A (Sinjalistika rrugore jondriçuese)*

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

*2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përllogaritur e fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

*2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve 2023, 2024 dhe 2025 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

*2.3.1 Përvoja e suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme*

*Operatori ekonomik duhet të dëshmojë përvojë të suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme, duke paraqitur një nga alternativat e mëposhtme:*

- a) *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm, me një vlerë jo më të vogël se 45 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës dhe të deklaruara në organet tatimore;*
- ose*

---

b) Punë të ngjashme, ku vlera totale monetare e punëve të realizuara gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe të deklaruar në organet tatimore.

Përmbushja e njërit prej kushteve të mësipërme e bën ofertën të kualifikueshme.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkohen vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, kërkohen si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruar në organet 39 tatimore si dhe situacioni përfundimtar dhe akt kolaudimi

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikata të vlefshme të lëshuara nga organizma të akredituar, si më poshtë:

- SSH/EN ISO 9001:2015 – Sistemi i menaxhimit të cilësisë/ose ekuivalent;
- SSH/EN ISO 14001:2015 – Sistemi i menaxhimit mjedisor/ose ekuivalent;
- SSH/EN ISO 45001:2018 – Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë/ose ekuivalent;
- SSH/EN ISO 39001:2012 – Sistemi i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor/ose ekuivalent, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të disponojë stafin teknik si më poshtë:

Një inxhinier ndërtimi, i diplomuar në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit, profili infrastrukturë transporti.

Një inxhinier mekanik, i cili të ketë eksperiencë ose trajnim të provueshëm në fushën e sinjalistikës dhe sigurisë rrugore.

Dy punonjës për realizimin e vijëzimeve në asfalt, të pajisur me dëshmi ose certifikatë kualifikimi përkatëse.

Dhjetë punëtorë të thjeshtë.

Një punonjës i certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”.

Ky kriter do të përmbushet nga operatori ekonomik nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të paraqesë dokumentacionin provues për stafin teknik, përfshirë diplomat për inxhinierët, dëshmitë/certifikatat e kualifikimit për punonjësit përkatës, kontratat e vlefshme të punës, si dhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore, me qëllim vërtetimin e kualifikimit dhe marrëdhënies së punësimit. Ky dokumentacion duhet të dorëzohet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet teknike si më poshtë:

- Një makineri për aplikimin e bojës termoplastike (APV);
- Një makineri vijëzimi vetëlëvizëse me bojë bikomponente (paste);
- Një kamionçinë me kapacitet mbajtës jo më pak se 1.5 ton;
- Një kompresor i lëvizshëm;
- Një gjenerator;
- Dy sete semaforësh për kontrollin e trafikut;
- Një mjet për pastrimin e vijëzimeve/bojës ekzistuese;

- *Një mjet transporti ATV – karrotrec me kapacitet mbajtës 2–2.5 ton.*

*Për mjetet dhe pajisjet e sipërcituara, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:*

*Për mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit, si dhe taksat vjetore, si dhe leja e transportit të mallrave brenda vendit për ato mjete për të cilat kërkohet pajisja me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi.*

*Për mjetet e marra me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit, si dhe leja e transportit të mallrave brenda vendit për ato mjete për të cilat kërkohet pajisja me leje transporti sipas legjislacionit në fuqi. Mjetet duhet të shoqërohen me kontratë qiraje të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera, duhet të paraqiten aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

*Për mjetet dhe pajisjet që nuk regjistrohen në regjistrat publikë, duhet të paraqiten dokumentet që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

*Për pajisjet teknike, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose kontratat e shitblerjes. Kur janë me qira, duhet të paraqiten kontratat noteriale të qirasë, si dhe faturat tatimore të shitjes ose kontratat e shitblerjes, sipas rastit. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar me TVSH (faturat e biznesit të vogël) duhet të shoqërohen me kuponin tatimor.*

*Ky kriter do të përmbushet nga operatori ekonomik nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton disponimin e automjeteve dhe makinerive, duhet të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

*2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave/materialeve të përcaktuara në preventiv, ose nga distributori i autorizuar prej tij, që garanton furnizimin me të gjitha materialet e nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate.*

*Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota identifikuese të prodhuesit dhe/ose distributorit të autorizuar, përfshirë emrin e shoqërisë, adresën, numrin e kontaktit, adresën elektronike dhe faqen zyrtare të internetit.*

*Në rast se autorizimi lëshohet nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion provues që vërteton marrëdhënien zyrtare ndërmjet prodhuesit dhe distributorit të autorizuar.*

*2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë të prodhuesit, ose fragmente katalogësh, si dhe/ose skeda teknike (datasheet) për të gjitha materialet dhe produktet objekt prokurimi, të parashikuara në preventiv.*

*Dokumentacioni i paraqitur duhet të identifikojë qartë produktet e ofruara, duke përfshirë emërtimin tregtar, markën, modelin ose çdo element tjetër identifikues të tyre, në mënyrë që të mundësohet gjurmueshmëria e produktit dhe verifikimi i origjinës së tij.*

*Skedat teknike dhe/ose katalogët duhet të përmbajnë në mënyrë të plotë dhe të detajuar të gjitha karakteristikat teknike të produkteve, përfshirë parametrat funksionalë, fizikë dhe cilësorë, me qëllim që Autoriteti Kontraktor të verifikojë përputhshmërinë e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.*

---

*Në rastet kur katalogët nuk përmbajnë të gjitha të dhënat teknike të kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion shtesë teknik nga prodhuesi, i cili plotëson informacionin e munguar.*

*2.3.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë në datën dhe orën e hapjes se prokurimit, mostër të produkteve: bojë bikomponente spray e bardhë, përvijues modularë të kthesave (çift), tabelë rrethi "ndalim" normal me  $D = 60$ , barrierë mbrojtëse (guardrail) H1 anësore me 2 valë në një anë, tip W3, + aksesorët.*

*Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë në datën dhe orën e hapjes se tenderit, me adresë: pranë stadiumit, Himarë.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- -
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -----

#### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik  
(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et


## Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

## **B: DEKLARATA**

### **Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura**

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

